

VENDIM
Nr.486, datë 8.4.2008

PËR PËRDORIMIN E FONDEVE BUXHETORE PËR TRANSPORTIMIN E
MËSUESVE DHE TË NXËNËSVE QË PUNOJNË E MËSOJNË JASHTË
VENDBANIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpenzimet e transportimit të mësuesve që punojnë larg vendbanimit, në distancë mbi 4 km, dhe kthehen brenda ditës, si dhe shpenzimet e transportimit të nxënësve që ndjekin arsimin e detyrueshëm larg vendbanimit, në distancë mbi 2 km, të përballohen nga fondet e Buxhetit të Shtetit.

2. Shërbimi i transportimit të mësuesve dhe nxënësve kryhet vetëm në rastet e linjave interurbane. Drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore përcaktojnë hartën e linjave për distancat e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, si dhe listën e mësuesve dhe të nxënësve, që do të lëvizin në këto linja, të miratuar nga drejtorët e shkollave.

3. Shpenzimet dhe fondi limit për këto shërbime prokurohen në mbështetje të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nga çdo drejtori arsimore rajonale dhe zyrë arsimore, sipas hartës së miratuar të linjave.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

5. Vendimi nr.208, datë 8.5.1997 i Këshillit të Ministrave “Për përballimin e shpenzimeve të transportit për mësuesit e nxënësit, që punojnë e mësojnë jashtë vendbanimit”, të ndryshuar, shfuqizohet.

6. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha